

RELACION TEKNIK
PER OBJEKTIN “NDERTIM I TREGUT TE MALLRAVE TE PERDORUR”
BASHKIA GRAMSH

A large, semi-transparent watermark logo is centered on the page. It features a stylized 'Open' in a light red font, with 'Procurement' in a smaller grey font below it, and 'Albania' in a large grey font at the bottom. To the left of the text is a circular graphic element composed of concentric, slightly offset rings in shades of red and white.

Gramsh, 2019

Tregu i mallrave te perdorura ne qytetin e Gramshit ka filluar te funksionoj qe nga viti 1992.

Ky treg ka qene organizuar ne vende te ndryshme te qytetit kryesisht ne hapësira publike te krijuara nga tregtare te ndryshem te cilet dolen te papune per shkak te ndryshimit te sistemit e kalimit ne ekonomine e tregut.

Deri vone keto tregje kane funksionuar kryesisht ne rrugen “Devoll” qe fillon nga sheshi kryesor I qytetit deri tek Pallati I Kultures duke shfrytezuar si trotuaret ashtu edhe rrugen ne nje gjatesi prej rreth 200ml.

Ne kete treg ushtrojne aktivitet rreth 60 tregtare.Me qene se ky treg eshte afer qendres se qytetit dhe ne rruge automobilistike nuk ishte I pershtatshem per kete funksion per shume arsye por me kryesoret ishin:

- Pengimi I qarkullimit te automjeteve dhe burim aksidentesh per komunitetin
- Paraqitja e pakendshme e ambjentit te organizimit dhe per menyren e funksionimit
- Krijimi I zhurmave per banoret e apartamenteve ne banesat anash kesaj rruge etj.

Me rikonstrukcionin e kesaj rruge per kthimin e saj ne pedonale me akses te madh ne permiresimin e mjedisit prane qendres se qytetit me qellim te mos nderpritet aktiviteti ne zonen e ish repartit Ushtarak.

Tregu funksionon kryesisht ne rrugen automobilistike “Kodrionasi” por qe I mbart me vete anet negative qe ekzistonin edhe ne rrugen “Devolli”.

Per zgjidhjen perfundimtare te funksionimit te ketij tregu mendohet te shfrytezohet depresioni natyror territory public rreth 100 meter te Pallatit te Kultures ne anen perendimore te kendit sportive.Tregu mendohet te jete I rrethuar dhe I mbuluar me nje siperfaqe prej rreth 0.1 Ha.

Ne varesi nga kushtet e terrenit, menyra e funksionimit dhe e organizimit ,tregu mendohet ne tre platforma te shtruara me beton qe lidhen me shkalle ndermjet tyre si dhe dy porta; nje per futjen e automjeteve dhe nje per hyrje-daljen e klientave.

Tregu do te jete I ndricuar per naten si dhe do te kete nje nyje hidrosanitare e me ZWC.

Per zbatimin e ketij tregu eshte e nevojshme te kryhen volume pune te konsiderueshme qe per disa procese kryesore sipas projekt preventivit paraprak te hartuar jane si me poshte:

- Punime dheu rreth 800 m3

- Punime betoni rreth 260 m3
- Punime konstrukcion metali rreth 4 Ton
- Punime catie rreth 860 m2
- Punime shtrese zhavorr rreth 100 m3
- Punime shtrese beton rreth 80 m3
- Punime shtrese lluster cimento rreth 800 m2
- Punime K.U.B dhe K.U.Z rreth 470 000 leke
- Punime rrethimi rreth 160 m2
- Punime nyje hidrosantare WC rreth 370 000 leke
- Punime ndricimi rreth 450 000 leke

Per ndertimin e ketij objekti eshte I nevojshem nje fond prej **10 milion leke**. Me realizimin e ketij investimi do te zgjidhet problem I tregetimit te mallrave te perdorura ne menyre te organizuar,te disiplinuar ,te siguruar dhe te kontrolluar.

Ne keto kushte permiresohen edhe me tej kushtet higjieno-sanitare si dhe nuk do te kete me pamje te pakendshme neper rruget e qytetit te Gramshit.

Persa me siper hartohet ky relacion teknik.

Hartoi

Ing. Ali ÇOHODARI